



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istok

Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istok

Komitetit për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and
Finance Committee

27	Procesverbal
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	23.06.2020, në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lart për Përkrahje të Kuvendit të Komunës së Istogut
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Zenel Shatri, Besa Ferati, Haki Podrimaj, Metaj dhe Ardita Idrizaj
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Hazbi Bajra, Edona Bujupi-Loxha, Osmon Sadikaj, Hajrush Shoshi, Enver Rugova, Mujë Osmanaj, Hysni Maxhatraj, Lulzim Blakaj, Drin Sadikaj, Ardon Arifaj, Fjolle Berisha.
Rendi i ditës:	
<ol style="list-style-type: none">1. Konstatimi i prezencës së anëtareve të Kuvendit,2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021-2023,4. Shpallja në diskutim publik i Projekt - Rregullores për Kodin e Etikes për zyrtaret e Komunës së Istogut.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi z. Qaush Balaj, përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Në mbrojtje të infektimit nga pandemia dhe respektimit të masave ndaj virusit Covid 19, Sall që jemi tani është dezinfektuar, anëtarët e komitetit si dhe të pranishmit tjera janë pajisur me maska, doreza dhe dezinfektues në tavolina.</p> <p>Hapë punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.</p> <p>Prezanton rendin e ditës,</p> <p>Fton Ekzekutivin si dhe Anëtarët e KPF-së nëse dikush ka ndonjë pyetje sugjerim apo ndonjë propozim për rend dite?</p> <p>Fjalën ja kalon Drejtorit Lulzim Blakaj,</p> <p>Lulzim Blakaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kërkoj falje së kur ka përfunduar rishikimi ka dal tenderi për asfaltimin e rrugës në Lluga "Lagja Balaj" si rrjedhojë e tenderit aty kanë tepruar</p>	

8300.00 Euro mirë po paraprakisht është shumë e domosdoshme që në atë pjesë ku po asfaltohet rruga të ndërtohet edhe kanalizimi faktikisht në këtë vit nuk mund të ndërtohet kanalizimi se është një kosto shumë e lartë po kemi paraparë që këtë vit të instalohen gypat e kanalizimit dhe dhe puseta të cilat kalojnë përgjatë rrugës në mënyre që vitet tjera kur të bëhet kanalizimi në atë pjesë mos të dëmtohet kjo rrugë.

Propozoj si pikë të rendit të ditës që 8300.00 euro nga projekti ndërtimi i rrugës në "lagjen Balaj" të ridestinohet për gropimin e gypave të kanalizimit dhe shaktave- pusetave.

Hysni Maxharraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, propozoj Pikë të re për rendin e ditës Njoftimi me Raportin e progresit për realizimit e Planit të Veprimit për mënjanimin e të gjeturave në raportin e Auditorit të përgjithshëm.

Kjo pik është dashur të jetë në muajin marsë po për shkak të pandemisë nuk kemi mundur, grupi punuese janë mbledhur dhe ka punuar, Raporti është i gatshëm.

Enver Rugova - përshëndet të gjithë të pranishmit, në kuadër të Komunës Drejtoria për Shërbime Publike e ka për obligim shpërndarjen e pakove higjienike dhe ushqimore nga donatorët, dhe Propozoj Pikë të re për rendin e ditës: Njoftimi rreth shpërndarjes se pakove emergjente nga buxheti i komunës dhe donatorëve për periudhën e pandemisë Covid 19,

Zenel Shatri - përshëndet të gjithë të pranishmit, mua po me duket se shumë po e zgjerojmë këtë mbledhje me shumë pika të rendit të ditës, po flas edhe si profesionist i gjendjes aktuale që sa ma shkurtë me nejtë në ambiente të mbyllura sepse Covidi është duke na rrezikuar për dit e me shumë. Me i shtuar edhe tri pika të rendit të ditës unë nuk jam për, nëse ka mundësi mund ta mbajmë një dit kur të doni, e caktojmë si të keni kohë. Kemi KAB-in që kemi shumë punë në të kemi edhe këto pikat tjera që janë të rëndësishme dhe mi i shti edhe tri pika tjera, duhet sa ma shpejt me i përfundua nuk mund ta zgjat mbledhja shumë sepse nuk jemi në një gjendje të cilën mund ta zgjatemi. Kemi kontakte për ditë me Covid mund të sëmurëmi edhe ne.


Eliot Kukiqi - përshëndet të gjithë të pranishmit, jam dakord me doktorin të rialokimi i mjeteve ndoshta nuk pret, dhe disa se janë me urgjente ti hyn disa se mund të presin mos të hynë.

Zenel Shatri - edhe unë pajtohem me atë se çka është me urgjencë të hy jo të gjitha.

Kryesuesi - hedh në miratim këto propozim :

Njoftimi me Raportin e progresit për realizimit e Planit të Veprimit për mënjanimin e të gjeturave në raportin e Auditorit të përgjithshëm.

Miratohet një zëri,



Shqyrtimi dhe Miratim i propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për Ridestinimin e mjeteve në kuadër të te programit buxhetor zhvillimi Ekonomik,

Miratohet një zëri,

Njoftimi rreth shpërndarjes se pakove emergjente nga buxheti i komunës dhe donatorëve për periudhën e pandemisë Covid 19,

Miratohet një zëri,

Hedhje në miratim Rendin e ditës me këto pika, komplet

Miratohet një rendi.

Vendimet:

Miratohet njëzëri rendi i ditës, me këtë propozim nga Ekzekutivi.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 1.

Diskutimet:

Kryesuesi -- Konstatimi i prezencës së anëtareve të Kuvendit, Konstatohet që të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa janë prezentë në këtë mbledhje, dhe mund të fillojmë me pikat në vazhdim.

Vendimet:

Vazhdojmë me mbledhjen

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Shqyrtimi i pikës 2.

Diskutimet:

Kryesuesi, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni.

Kryesuesi - a ka dikush t diçka.

Zenel Shatri - kam një vërejtje, ku kamë kërkuar të hynë trotuari Gurrakoc- Tomoc nuk kamë thënë që të kryhet ky projekt një here pastaj për arsim i gjejmë paret pastaj, por kamë thënë të kundërtën nëse nuk ka në Arsim pare jam për arsim kam thënë edhe në Kuvend le të mbesin në arsim Zyrtares kryesor financiar ka thënë që ka edhe për arsim atëherë kam propozuar këtë, le të përmirësohet aty.

Pasi që diskutime nuk pat hedh në miratim.

Vendimet:

Miratohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, me vërejtje.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Shqyrtimi i pikës 3.

Diskutimet:

Kryesuesi, vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021-2023. Kryetari i Komunës ka mbajtur një dëgjim publik me qytetar aty kemi pasur disa propozim ku i keni para vetes sepse i ka shpërnda sekretaria.

Osmon Sadikaj ZKF - përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e **Kornizës Afatshkurtesme Buxhetore 2021-2023.**

Haki Podrimaj - Propozon: Ndërtimi i Rr. "Rexhë Kastrati" fshati Baicë Lagja Demaj 1000m,

- Ndërtimi i trotuarit Baic, rruga e Banjës, deri të varrezat e Corollukës 1 kilometër e gjysmë,
- Ndërtimi i Rr. Baic, rruga e Banjës, deri të varrezat e Corollukës, 1 kilometër e gjysmë
- Ndërtimi i Kanalit të ujitjes që fillon në Baicë të Mulliri i Morinëve vjen të ura e Baicës vazhdon në Baicen e poshtme përpara ka qenë mulliri i Kastratve vazhdon deri në Kashicë, me gjatësi prej 4.5 kilometra,
- Pastrimi i Kanalit të Maxharrit që fillon nga Cerrolluka dhe vazhdon deri në Dobrushë poshtë, vlera 20 mijë euro,
- Ndërtimi i kanalizimit në Istog të Poshtëm lagja Hysenaj, Llapaj, Kurtaj,

Kryesuesi - a jeni që këto propozime të hynë në KAB kush është për:
Anëtarët e KPF-së unanimit miratojnë që këto projekte të hyn në KAB.

Zenel Shatri - propozon : Ndërtimi i Kanalizimit në Tomoc lagja e Bregut dhe Imorovite (Shatri).

Kryesuesi - a jeni që këto propozime të hynë në KAB kush është për:
Anëtarët e KPF-së unanimit miratojnë që këto projekte të hyn në KAB.

Ajshe Metaj - propozon: Vazhdimi i trotuarit Staradran, Kashicë dhe Banjë,

- Ndërtimi i një shtëpie të kulturës në fshatin Kamenica,
- Ndërtimi i një kanali të ujitjes të lagja Januzaj, 700 m.
- Ndërtimi i Rrugës së bjeshkës e Kaliqanit të Osmanajt 400 m.



Kryesuesi - a jeni që këto propozime të hynë në KAB kush është për:
Anëtarët e KPF-së unanimit miratojnë që këto projekte të hyn në KAB.

Ardita Idrizaj- Propozon : Ndërtimi i trotuarit Lubozhdë - Vrellë,

- Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Lubozhdë lagja Pepaj,
- Ndërtimi i Rrugës në fshatin Lubozhdë lagja Pepaj, 500 m
- Ndërtimi i kanalit të uji i pijes në fshatin Lubozhdë lagja Pepaj,

Kryesuesi - a jeni që këto propozime të hynë në KAB kush është për:
Anëtarët e KPF-së unanimit miratojnë që këto projekte të hyn në KAB.

Eliot Kukiqi - Propozon, Ndriçimi në fshatin Gurrakoc Rr. "Nimon Kabashi deri të Gegajt,

- Ndërtimi i rrugës në fshatin lagja Januzaj Rr. "Lisi" dhe "Sadik Maksutaj" 450m (rrugë me dry emra)

Kryesuesi - a jeni që këto propozime të hynë në KAB kush është për:
Anëtarët e KPF-së unanimit miratojnë që këto projekte të hyn në KAB.

Besa Ferati, Propozon : Ndërtimi i trotuarit në Gurrakoc lagja "Osmanaj" (Ukist).

~~Kryesuesi – pasi që këto propozime të hynë në KAB kanë mbetur për:~~

Anëtarët e KPF-së unanimit miratojnë që këto projekte të hyn në KAB.

Të gjitha këto propozime do të hynë në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2021-2023.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës

Nga anëtarët e KPF-së miratohet unanimit,

Vendimet:

Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja në mënyrë unanime: Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023, ia kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi, vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës Shpallja në diskutim publik e Projekt - Rregullore për Kodin e Etikes për zyrtarët e Komunës së Istogut. Draftin e keni pasur dhe keni pasur mundësi ta shikoni i kemi procedurat për Rregullore e cila do të miratohet në KK për shpallje në dëgjim publik dhe pastaj prap ka për të dalë në kuvend me propozimet nga dëgjimi publik. A ka dikush diçka rreth këse Rregulloreje.

Hysni Maxharaj - prezanton dhe sqaron, Projekt - Rregullore për Kodin e Etikes për zyrtarët e Komunës së Istogut.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës

Nga anëtarët e KPF-së miratohet unanimit,

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Shpallet në diskutim publik i Projekt - Rregullore për Kodin e Etikes për zyrtarët e Komunës së Istogut. si dhe i njëjti i kalohet KK-së për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 5.

Diskutimet:

Kryesuesi, po vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe Miratim i propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për Ridestinimin e mjeteve në kuadër të te programit buxhetor zhvillimi Ekonomik, a ka dikush diçka rreth kësaj pike.

Lulzim Blakaj - bën prezantimin dhe sqarimin e propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për Ridestinimin e mjeteve në kuadër të te programit buxhetor zhvillimi Ekonomik.

Kryesuesi pasi që diskutime nuk ka po e hedhe në votim

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF unanim rekomandon: Shqyrtimi dhe Miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për Ridestinimin e mjeteve në kuadër të të programit buxhetor zhvillimi Ekonomik, dhe të njëjtin ia kalohet KK për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës Njoftimi me Raportin e progresit për realizimit e Planit të Veprimit për mënjanimin e të gjeturave në raportin e Auditorit të përgjithshëm, ka dikush diçka rreth kësaj pike.

Hysni Maxharraj - bën prezentimin dhe sqarimin e Raportit të progresit për realizimit e Planit të Veprimit për mënjanimin e të gjeturave në raportin e Auditorit të përgjithshëm,

Kryesuesi - pasi që diskutime tjera nuk ka, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja i rekomandon: Njoftimi me Raportin e progresit për realizimit e Planit të Veprimit për mënjanimin e të gjeturave në raportin e Auditorit të përgjithshëm, si dhe i njëjti i kalohet KK-së për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 7.

Diskutimet:

Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës Njoftimi rreth shpërndarjes së pakove emergjente nga buxheti i komunës dhe donatorëve për periudhën e pandemisë Covid 19,

Enver Rugova -Njofton rreth shpërndarjes së pakove emergjente nga buxheti i komunës dhe donatorëve për periudhën e pandemisë Covid 19,

Kryesuesi - pasi që diskutime tjera nuk ka, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF - ja i rekomandon: Kryesuesi - pasi që diskutime tjera nuk ka, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, dhe të njëjtin ia kalohet KK për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Diskutime tjera:

Kryesuesi, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj: 12:30

